



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Nr. 17-020/04-94289, më 19 JUL 2024

Në bazë të dispozitave të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Rregullores (QRK) - Nr. 23/2023 Për procedurat e punës në tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr.110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet themelimi i Tryezës Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, Tryeza Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit, ka këtë përbërje:
 1. Menaxheri i rastit nga Qendra përkatëse për Punë Sociale;
 2. Ndihmës menaxheri i rastit nga QPS;
 3. Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave - Mbrojtësi i Viktimave;
 4. Shërbimi Sprovues i Kosovës - Zyrtari i Shërbimit Sprovues;
 5. Qendra e Mjekësisë Familjare - mjekë specialistë sipas specifikave të rastit;
 6. Policia e Kosovës;
 7. Qendra për Shëndet Mendor - specialist i fushës për trajtimin e fëmijëve;
 8. Drejtoria Komunale për Arsim - Zyrtar për Arsim;
 9. Drejtoria Komunale për Mirëqenie Sociale - Zyrtari përgjegjës;
 10. Psikologu/Punëtori, Social/Pedagogu i Shkollës ose përfaqësues i deleguar nga institucioni edukativo-arsimor;
 11. Zyra Komunale për Komunitete - Zyrtari për Komunitet;
 12. Institucioni për Strehim Përkujdesës ose familja strehuese;
 13. Zyra Komunale për të Drejtat e Njeriut - Zyrtari për të Drejtat e Njeriut/Fëmijës;
 14. Përfaqësues të Organizatave Joqeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së Fëmijës.
3. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi, Tryeza Multidisiplinare është nën udhëheqjen e menaxherit të rastit dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - Trajton rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pas dore në bazë të interesit më të mirë të fëmijës;
 - përcjell dhe në vazhdimësi rishqyrton vlerësimin e rastit të bërë paraprakisht nga

- menaxheri i rastit, duke e plotësuar me informata të përditësuara varësisht nga ndryshimi i gjendjes së fëmijës apo rrethanave në rast;
- Bashkërendon dhe zhvillon procesin e planifikimit të përbashkët të veprimit për mbrojtje të fëmijës në përputhje me rrethanat dhe me legjislacionin përkatës në fuqi;
 - Koordinon ofrimin e shërbimeve për mbrojtje, rehabilitim, dhe integrim apo riintegrim të fëmijës, në mënyrë të qëndrueshme dhe përkrah familjet e tyre ose kujdestarin;
 - Rishikon planin individual për mbrojtjen e fëmijës në baza mujore, në raste specifike edhe më shpesh.
 - Harton raportin vjetor për punën e vet dhe raporton tek Komuna dhe sipas kërkesës edhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit për të Drejtat e Fëmijës.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet

- Anëtarëve,
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

